



Sërish gjenden armë dhe municion në Zveçan, arrestohet një person



22/11/2024 18:26



Policia e Kosovës njofton se sot pas pranimit të një informate mbi dyshimet për armë dhe municion, ka ndërmarrë veprimet e menjëhershme ku është kryer një kontroll në fshatin Grabovc të Zveçanit, gjegjësisht në një shtëpi dhe në një objekt përcjellës të saj.

Behet e ditur se gjatë kontrolli janë gjetur armë, municion dhe mjetë shpërthyesë.

Dëshmitë të cilat janë gjetur dhe janë konfiskuar janë:

- dy mjete shpërthyesë (granata dore) M-52,
- dy armë AK-47,
- një pushkë M-48 (karabinë)
- 86 copë fishekë të armës AK-47,
- 35 copë fishekë të armës M-48,
- 3 karikatorë të armës AK-47

Policia ka bërë të ditur se lidhur me rastin është arrestuar një 56-vjeçar me inicialet D.R., i cili është shoqëruar në stacioni policor. I njëjti është intervistuar në prezencën avokatit mbrojtës dhe me aktvendim të prokurorit, i dyshuari u dërgua në mbajtje për 48 orë.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM by LupaMedia



Artikuj të ngjashëm



November 22, 2024

Aksident me fatalitet në Krushë të Madhe, këmbësori goditet për vdekje



November 22, 2024

Ndërprerjet e energjisë për shkak të motit, KESCO del me njoftim



November 22, 2024

Reshjet e shiut bllokojnë Fushë Kosovën, shkaktohet tollovi dhe kaos në...



November 22, 2024

Ibrahimi: Komunat do të kenë 21 milionë euro më pak buxhet në vitin 2025



November 22, 2024

Përurohet Qendra e Re e Mjekësisë Familjare në Mamushë

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyra nr. 5

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

